

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Enver Peci, kryetar, Nesrin Lushta e Nazmije Ibrahim-anëtar, me bashkëpunëtorën profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve A. H., S. F., G. M. të gjithë nga Mitrovica dhe M. K. nga komuna e Mitrovicës, për shkak të veprave penale intoksikimi i personit tjetër me narkotik ose substancë psikotropike nga neni 276.lidhur me nenin 31.të KPK, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2. të KPK, nga neni 292.par.2.lidhur me nenin 26. të KPK dhe nga neni 273.par.2.lidhur me par.1.dhe 81.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit M. K. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.482/2013 të datës 18.10.2013. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.476/2013 të datës 27.05.2014., në seancën e mbajtur më 21.07.2016., mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit M. K. e paraqitur kundër aktgjykimit Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.482/2013 të datës 18.10.2013. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.476/2013 të datës 27.05.2014.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.482/2013 të datës 18.10.2013. të dënuarit A. H. dhe S. F. janë liruar nga akuza për veprën penale intoksikimi i personit tjetër me narkotik ose substancë psikotropike nga neni 276.lidhur me nenin 31.të KPK dhe blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2. lidhur me nenin 26.të KPK, ndërsa janë shpallur fajtor për veprën penale në vazhdim blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2. të KPK, i dënuari G. M. është shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2. të KPK ndërsa i dënuari M. K. është shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2. lidhur me par.1.dhe lidhur me nenin 81.të KPK dhe janë gjykuar: të dënuarit A. H., S. F. e G. M. me dënime me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj dhe dënime me gjobë në shuma prej nga 300 (treqind) €, ndërsa i dënuari M. K. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilat janë obliguar të paguajnë në afat prej 2 muajve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e ne rast të mospagimit ato do të zëvendësohen ne dënime burgimi duke llogaritur 20 € për një ditë burgimi e në dënimet me burgim iu është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, të dënuarit A. H. prej datës 19.02.2013. deri më datën 19.03.2013. dhe prej datës 19.03.2013. deri më datën 03.07.2013., të dënuarit S. F. prej datës 19.02.2013. deri më datën 19.03.2013., prej datës 19.03.2013. deri më datën 11.04.2013. dhe prej datës 11.04.2013. deri më datën 18.10.2013., të dënuarit G. M. prej datës 19.02.2013. deri më datën 19.03.2013. dhe prej datës 19.03.2013. deri më datën 03.07.2013. dhe të dënuarit M. K. prej datës 20.02.2013. deri më datën 08.05.2013. dhe prej datës 08.05.2013. deri më datën 26.06.2013.. Të dënuarit janë obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor dhe iu është shqiptuar dënimi plotësues i marrjes së

substancës narkotike kanabis në peshë prej 53.72 gr dhe një bluese, si mjete të kryerjes së veprës penale.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës ka marr aktgjykimin PAKR.nr.476/2013 të datës 27.05.2014. me të cilin është aprovuar ankesa e prokurorit Themelor në Mitrovicë dhe aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar ashtu që të dënuarit A. H. dhe S. F. janë shpallur fajtor për veprën penale intoksikimi i personit tjetër me narkotik ose substancë psikotropike nga neni 276.lidhur me nenin 31.të KPK dhe janë gjykuar me dënime burgimi në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti, ndërsa me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të tyre janë liruar nga akuza për veprën penale në vazhdim blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2. të KPK e me aprovimin e pjesëshëm të ankesave të mbrojtësve të dënuarve G. M. dhe M. K. aktgjykimi është ndryshuar përkitazi me vendimin për dënim ashtu që janë gjykuar me dënime burgimi të dënuarin G. M. në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe të dënuarin M. K. në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, ndërsa dënimet me gjobë kanë ngelur të pandryshuara.

Duke vendosur në shkallën e tretë, sipas ankesave të mbrojtësit të dënuarit A. H., Gjykata Supreme e Kosovës ka marr aktgjykimin PA.II.nr.4/2-15 të datës 01.07.2015. me të cilin ankesa është refuzuar dhe aktgjykimi i shkallës së dytë është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe atij të shkallës së dytë, mbrojtësi i të dënuarit M. K., avokati K. B. nga Mitrovica, ka paraqitur kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje si dhe të shtyhet ekzekutimi i dënimit të shqiptuar.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.214/15 të datës 16.12.2015. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Nga aktgjykimet e kundërshtuara rezulton se vepra e vazhduar penale për të cilën i dënuari M. K. është shpallur fajtor, përbëhet nga dy pjesë, njëra është ajo e kryer në muajin shtator/nëntor të vitit 2012. dhe ka të bëjë me posedimin e substancës narkotike me qëllim shitjeje, të cilën iu ka shitur të dënuarit S. F. dhe të dëmtuarit G. R. ndërsa e dyta e kryer më 19.02.2013. e cila ka të bëjë me posedimin me qëllim shitjeje të substancës narkotike në shtëpinë e tij.

Si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në kërkesë thuhet se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë arsye për dashjen e të dënuarit, gjegjësisht se veprën penale a e ka kryer me dashje direkte apo eventuale, se nuk është precizuar se sa herë i dënuari e ka shitur narkotikun por vetëm thuhet “disa here” dhe kjo dispozitivin e bënë të paqartë, se aktgjykimet bazohen në supozime sa i përket shitjes së narkotikut sepse asnjëri prej personave të dëgjuar nuk ka pohuar këtë fakt përveç dëshmitarit G. R., por ai ka qenë i pasigurt dhe disa here ka ndryshuar deklaratën, se në përshkrimin faktik të veprës penale nuk ceket se fjala është për një vepër të vazhduar penale, e që nuk ceket as në cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që dispozivi në këtë pikëpamje ka kundërshtim me vet vetën dhe të gjitha këto aktgjykimet e kundërshtuara i bëjnë të paqëndrueshme.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e cekura nuk janë të bazuara.

Sa i përket llojit të dashjes së të dënuarit, kjo gjykatë vlerësojë se vepra penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor mund të kryhet vetëm me dashje direkte, andaj, ashtu që kryesi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe ka dëshiruar kryerjen e saj dhe ky fakt qartazi del nga përshkrimi i veprimeve e të dënuarit. Arsyetim i posaçëm do të nevojitej në rast të llojit tjetër të dashjes ose të pakujdesisë. Andaj, u konstatua se në këtë

pikëpamje aktgjykimet e kundërshtuara nuk kanë mangësi e cila kishte për të paraqitur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Edhe pse i dënuari M. K. ka mohuar se të dënuarit S. F. dhe të dëmtuarit G. R. ka shitur narkotik të llojit marihuanë, në qese të vogla të paketuara dhe për atë sasi ka marrë të holla në shumë prej nga 5 €, gjykata nuk ka kushtuar besim mbrojtjes së tij, duke konsideruar se tenton ti shmanget përgjegjësisë penale si dhe për arsye se dëshmitari-i dëmtuari G. R. ka deklaruar të kundërtën. Nuk mund të merret si i saktë fakti se ky dëshmitar ka qenë i pasigurte dhe ka ndryshuar deklaratën, sepse për faktin vendimtar- blerjen e narkotikut nga i dënuari, nuk e ka ndryshuar asnjë herë. Për më tepër ai ka ditur emrin e plotë dhe nofkën e të dënuarit M. K., sepse këtë i ka treguar i dënuari S. F., ka përshkruar edhe automjetin e tij në të cilin i dënuari ka mbajtur narkotikut para shitjes-një automjet i markës “Alfa Romeo” e ngjyrës së kuqe nga i cili i dënuari ka marrë narkotikun. Edhe i dënuari M. K. ka pohuar se ka pas një automjet të tillë dhe se nofka e tij është “..”. Edhe pse nuk është vërtetuar se saktësisht sa herë i dënuari personave të cekur ka shitur narkotikun, është e qarte se këtë ka bërë më shumë se një herë, pra, disa herë, sepse ashtu ka deklaruar dëshmitari i emëruar. Duhet cekur se shitja e narkotikut, mjafton të ndodhë vetëm një herë dhe paraqet vepër penale nëse janë përmbushur edhe elementet tjera të cilat ligji i kërkon, ndërsa në këtë rast nuk ka ndikuar në shqiptimin e dënimit (eventualisht më të lartë) siç do të bëhet fjalë më poshtë. Andaj, nuk mund të aprovohet pretendimi se aktgjykimi bazohet në supozime dhe jo në vlerësimin e provave të administruara, siç pa bazë pretendohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Përkritazi me ekzistimin apo jo të një veprë të vazhduar penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2. lidhur me par.1.dhe lidhur me nenin 81.të KPK, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se në përshkrimin faktik të veprës penale nuk ceket se fjala është për një vepër të vazhduar penale, e që nuk ceket as në cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që dispozivi në këtë pikëpamje është i paqartë dhe ka kundërshtim me vet vetën. Për më tepër, fjala është për veprimet inkriminuese të ndërmarra njëra para vitit 2013. dhe tjetra në vitin 2013., ndërsa Kodi Penal i Kosovës i

cili ka pësuar ndryshime, aplikohet që nga fillimi i vitit 2013., ndryshimet kanë të bëjnë edhe me veprën penale e cila është objekt i aktgjykimit dhe edhe për këtë arsye instituti i veprës së vazhduar penale është i paqëndrueshëm.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, ekzistimi i veprës së vazhduar penale duhet të del nga përshkrimi i fakteve dhe nga ai përshkrim duhet të konkludohet se ekzistojnë së paku dy prej rrethanave të cekura ne dispozitën e nenit 81.të KPK. Këto rrethana janë: viktima e njëjtë e veprës penale, objekti i njëjtë i veprës, shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore, vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale dhe dashja e njëjtë e kryesit. Në rastin konkret përveç dashjes së njëjtë, nuk ekziston asnjë prej rrethane të cekura në këtë dispozitë ligjore, gjegjësisht nuk ekzistojnë së paku dy prej kushteve të cilat veprimet e të dënuarit kishin për të cilësuar si një vepër të vazhduar penale. Duhet theksuar se as periudha kohore shtator/nëntor 2012.-19.02.2013. nuk mund të konsiderohet si “situatë apo marrëdhënie e njëjtë kohore” gjegjësisht nuk mund të flitet për një kohë të atillë e cila veprimeve e të dënuarit i jep karakterin e një tërësie.

Megjithatë, Gjykata Supreme nuk e aprovojë pretendimin në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se duhet të konsiderohet se fjala është për bashkim veprash penale (dy vepra të ndara penale) apo për cilësimin tjetër juridik të veprës penale. Cilësimi juridik i veprës penale është i qëlluar sepse është vërtetuar se edhe në rastin e dytë, kur është fjala për gjetjen e narkotikut në shtëpinë e të dënuarit, nuk është fjala vetëm për posedim të paautorizuar por edhe me qëllimin e shitjes së narkotikut, të cilin fakt gjykata ka vërtetuar nga se narkotiku është gjetur i paketuar në qese të plasmanit si dhe ato që shërbejnë për mbushjen e narkotikut dhe bluersi i cili shërben për bluarjen e narkotikut. Kjo gjykatë nuk aprovojë pretendimin se veprimet e të dënuarit duhet të cilësohen si dy vepra penale të kryera në bashkimin real sepse në këtë mënyrë kishte për tu cenuar parimi reformatio in peius (neni 395. i KPPK), gjegjësisht i dënuari kishte për tu sjellë në situatë më të disfavorshme se sa mjete juridik të mos ishte ushtruar fare. Kjo për arsye se atëherë do të duhej që i dënuari të shpallet fajtor për dy vepra penale në vend për një veprë penale në vazhdim, dhe ti përcaktohen dënimet për secilin vepër veç e veç e pastaj të shqiptohet dënimi unik, konform dispozitës së nenit 80.të KPK, që do të thotë se duhej të shqiptohej dënimi më i madh se çdo dënim i veçant, e që me do e mos do të ishte

dënimi me burgim në kohëzgjatje më të gjatë se sa dënimi i shqitura me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh. Kjo edhe në rast se do të përcaktoheshin dënime të veçanta në minimumin ligjor të paraparë edhe për veprën e parë penale (në KPK i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale para vitit 2013. minimumi ligjor ka qenë dënimi me burgim prej një viti) edhe për veprën e dytë penale (në KPK i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale në vitin 2013. minimumi ligjor ka qenë dënimi me burgim prej dy vitesh).

Nga të gjitha këto u konkludua se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat në kërkesë pretendohen e as që në dëm të dënuarit është shkelur ligji penal.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 285/2015, më 21.07.2016.

Proçesmbajtësja,  
Mirlinda Mejzini

Kryetari i e kolegjit,  
Enver Peci